



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 101

2003

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.797, datë 4.12.2003	Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., Tiranë.....	4337
Vendim i KM nr.803, datë 4.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit.....	4337
Vendim i KM nr.804, datë 4.12.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje.....	4344
Vendim i KM nr.805, datë 4.12.2003	Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore.....	4352
Vendim i KM nr.806, datë 4.12.2003	Për miratimin e rregullave e të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim.....	4357
Vendim i KM nr.807, datë 4.12.2003	Për rregullat e dhënies në përdorim të shpellave.....	4358
Vendim i KM	Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të	4360

nr.808, datë 4.12.2003	rënda të ndërtimit.....	
Vendim i KM nr.809, datë 4.12.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i urës së re, Bogovë.....	4361
Vendim i KM nr.815, datë 4.12.2003	Për përdorimin e procedurës "Prokurim i drejtpërdrejtë" për studimin dhe projektimin e urës së Gomsiqes në aksin rrugor Vau i Dejës - Koman	4362
Vendim i GJK nr.34, datë 8.12.2003	Me objekt deklarinimin si antikushtetues të urdhrit nr.226, datë 20.8.2002 të Kryeministrit "Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike"	4362

VENDIM
Nr.797, datë 4.12.2003

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT” SHA
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 243 dhe 244 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe të nenit 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, (OST) sh.a., Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror.
 2. Objekti kryesor i veprimtarisë së OST sh.a., Tiranë është të sigurojë transmetimin e energjisë elektrike nga prodhuesi e sistemi rajonal i energjisë te sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike, të bëjë zhvillimin e rrjetit të transmetimit në bashkërendim me gjeneruesit dhe shpërndarësit, të mirëmbajë dhe të zhvillojë interkonjeksionet e rrjetit të transmetimit.
 3. KESH sh.a., duke filluar nga data 1.4.2004, të bëjë ndarjen e llogarive financiare të shoqërisë së re, të krijuar sipas këtij vendimi.
 4. KESH sh.a., Tiranë ruan të gjitha të drejtat mbi asetet, që i përgjigjen objektit të shoqërisë së krijuar, deri në çastin e kalimit të tyre në kapitalin e OST sh.a., Tiranë.
 5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.803, datë 4.12.2003

PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË CILËSISË SË AJRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e normave të cilësisë së ajrit, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mjedisit të miratojnë rregulloren e monitorimit të cilësisë së ajrit.
 3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Aneksi 1: NORMAT E CILESISE SE AJRIT

(Ne kuptim te ketij vendimi ne normat e cilesise se ajrit nuk perfshihen normat e mjediseve te brendeshme te banimit dhe te punes)

Nr. rendor	NDOTESI	VLERAT E STANDARDIT	TIPI I STANDARDIT
1.	Monoksid karboni (CO)		
	Mesatare 24-oreshe****	2 mg/m ³	Primar*
	Mesatare 8-oreshe	10 mg/m ³	Primar
	Mesatare 1-oreshe	40 mg/m ³	Primar
2.	Bioksid azoti (NO₂)		
	Mesatare vjetore arithmetike***	60 µg/m ³	Primar &
	Sekondar**		
	Mesatare 4-oreshe	95 µg/m ³	Sekondar
	Mesatare 1-oreshe	250 µg/m ³	Primar
3.	Ozon (O₃)		
	Mesatare vjetore arithmetike	65 µg/m ³	Sekondar
	Mesatare 8-oreshe	120 µg/m ³	Primar &
	Sekondar		
	Mesatare 1-oreshe	235 µg/m ³	Primar &
	Sekondar		
4.	Plumb (Pb)		
	Mesatare vjetore arithmetike	1.0 µg/m ³	Primar &
	Sekondar		
	Mesatare 24-oreshe****	1.5 µg/m ³	Primar &
	Sekondar		
5.	Lende e grimcuar e depozituar (LGD)		
	Mesatare vjetore arithmetike	350 mg/(m ² /dite)	Primar &
	Sekondar		
		(Koha e matjes 1 muaj)	

6.	Lende e grimcuar pezull (LGP)		
	Mesatare vjetore arithmetike	140 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
	Mesatare 24-oreshe	250 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
7.	Lende e grimcuar < 10 mikrometer (PM 10)		
	Mesatare vjetore arithmetike	60 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
	Mesatare 24-oreshe	150 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
8.	Lende e grimcuar < 2.5 mikrometer (PM 2.5)		
	Mesatare vjetore arithmetike	15 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
	Mesatare 24-oreshe	65 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
9.	Bioksid squfuri (SO₂)		
	Mesatare vjetore arithmetike	60 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
	Mesatare vjetore arithmetike	35 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Sekondar
	Mesatare 24-oreshe	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
	Mesatare 1-oreshe	360 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Sekondar
	Mesatare 10-min	500 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Sekondar
10.	Amoniak (NH₃)		
	Mesatare vjetore arithmetike	70 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
	Mesatare 24-oreshe	250 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
11.	Sulfur hidrogjeni (H₂S)		
	Mesatare 24-oreshe	3 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			
	Mesatare 1-oreshe	10 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
Sekondar			

12. Merkaptane (RSH)			
Mesatare 24-oreshe	2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
Mesatare 1-oreshe	5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
13. Fenole ($\text{C}_6\text{H}_5\text{OH}$)			
Mesatare 24-oreshe	50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
Mesatare 1-oreshe	200 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
14. Formaldehide (HCHO)			
Mesatare 24-oreshe	30 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
Mesatare 1-oreshe	100 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
15. Acid klorhidrik (HCl)			
Mesatare 24-oreshe	100 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
Mesatare 1-oreshe	300 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
16. Acid fluorhidrik (HF)			
Mesatare vjetore arithmetike	0.5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar
Mesatare 30 -min	2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			
17. Acetaldehide (CH_3CHO)			
Mesatare vjetore arithmetike	70 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar
Mesatare 24-oreshe	2000 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		Primar &
Sekondar			

18.	Aceton (CH₃)₂ CO Mesatare vjetore arithmetike Mesatare 24-oreshe Sekondar	150 µg/m ³ 1000 µg/m ³	Primar Primar &
19.	Akroleine (CH₂CHCHO) Mesatare vjetore arithmetike	70 µg/m ³	Primar
20.	Acid akrilik (CH₂CHCOOH) Mesatare vjetore arithmetike	80 µg/m ³	Primar
21.	Dysulfur karboni (CS₂) Mesatare 24-oreshe Sekondar	25 µg/m ³	Primar &
22.	Tetraklorur karboni (CCl₄) Mesatare vjetore arithmetike	10 µg/m ³	Primar
23.	Tym dizeli Mesatare vjetore arithmetike Mesatare vjetore arithmetike	10 µg/m ³ 5 µg/m ³	Primar Sekondar
24.	Benzen (C₆H₆) Mesatare 8-oreshe Sekondar	5 µg/m ³	Primar &
25.	1,3-Butadien (CH₂CHCHCH₂) Mesatare 8-oreshe	1 µg/m ³	Primar & Sekondar
26.	3,4-Benz-piren (C₂₀H₁₂) Mesatare 24-oreshe	2 ng/m ³	Primar & Sekondar
27.	Fluorure te gazte		

	Mesatare 24-oreshe	2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar & Sekondar
	Mesatare 8-oreshe	5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar & Sekondar
28.	Kadmium (Cd)		
	Mesatare vjetore arithmetike	5 ng/m^3	Primar
29.	Krom^(VI) Cr		
	Mesatare vjetore arithmetike	0.5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
30.	Nikel (Ni)		
	Mesatare vjetore arithmetike	5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
31.	Mangan (Mn)		
	Mesatare 24-oreshe	2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
32.	Vanadium (Va)		
	Mesatare 24-oreshe	2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar
33.	Avuj zhive (Hg) dhe komponime inorganike		
	Mesatare 24-oreshe	1 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
	Sekondar		
34.	Arsenik (As)		
	Mesatare vjetore arithmetike	5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
	Sekondar		
35.	Sulfate në LGP		
	Mesatare 24-oreshe	50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
	Sekondar		
36.	Stiren (C₆H₅ - CH = CH₂)		
	Mesatare 24-oreshe	100 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar &
	Sekondar		

	Mesatare 30-min	400 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
37.	Tetrakloretilen (C_2Cl_4)			
	Mesatare 24-oreshe	400 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
	Mesatare 30-min	12000 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
38.	Triklloretilen (Cl CH CCl_2)			
	Mesatare vjetore arithmetike	50 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	
39.	Toluen ($\text{C}_6\text{H}_5 - \text{CH}_3$)			
	Mesatare 24-oreshe	420 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
	Mesatare 30-min	1500 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
40.	Ksilen $\text{C}_6\text{H}_4(\text{CH}_3)_2$			
	Mesatare vjetore arithmetike	1200 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	
	Mesatare 24-oreshe	8000 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
41.	Peroksiacetilnitrat (PAN)			
	Mesatare 8 -oreshe	120 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Primar	&
	Sekondar			
	Mesatare 1 -oreshe	500 $\mu\text{g}/\text{m}^3$		
	Primar			

* **Standardet primare** janë kufij që shërbejnë për të mbrojtur shëndetin e popullatave "te ndjeshme" si azmatiket, fëmijte dhe pleqte.

** **Standardet sekondare** janë kufij që shërbejnë për të mbrojtur mirëqenien publike, duke përfshirë mbrojtjen kundrejt uljes së pamjes, demtimit të kafsheve, të mbjellave, bimesise dhe ndërtesave.

*** **Mesatare Vjetore Arithmetike** me minimum 183 dhe maksimum 365 matje në vit, nga 24 orë sejcila (që mbulojnë 50 – 100 përqind të vitit).

**** **Vlerat 24 orë/8orë** duhet të mos tejkalohen në 98% të kohës në një vit.

Megjithatë, në 2% të kohës ato mund të tejkalohen (7 ditë/vit), por jo në dy ditë të një pasnjëshme.

VENDIM
Nr.804, datë 4.12.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SPECIEVE TË FLORËS SHQIPTARE, QË VIHEN NË MBROJTJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të Konventës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës”, ratifikuar me ligjin nr.8294, datë 2.3.1998, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë e tij.

2. Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve e të Kullotave dhe me institutet shkencore përkatëse, si dhe në mbështetje të kategorizimeve europiane, të përcaktojë statusin e mbrojtjes së çdo specieje të përmendur në aneksin 1.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E SPECIEVE TË MBROJTURA TË FLORËS SHQIPTARE

Nr	Indeksi i emrave latinisht	Indeksi i emrave shqip
1.	<i>Acer hyrcanum</i>	Panja e Hierkarise
2.	<i>Acer monspessaianum</i>	Krekez
3.	<i>Aconitum lamarchii</i>	Akonit i Lamarkut
4.	<i>Achillea clusiana</i>	Barepezem kluzian
5.	<i>Achillea fraasii</i>	Barepezem i frasit
6.	<i>Achillea grandifolia</i>	Barepezem gjethemadh
7.	<i>Aesculus hippocastanum</i>	Geshtenje e eger
8.	<i>Agrimonia eupatoria</i>	Rrodhez
9.	<i>Ajuga piskoi</i>	Ajuge e Piskoit
10.	<i>Alkanna corcyrensis</i>	Allkene e Korfuzit
11.	<i>Alkanna scardica</i>	Allkene e Sharit
12.	<i>Alyssoides utriculata</i>	Allisoid kacekthor
13.	<i>Alyssum bertolonii</i>	Lule me çikez
14.	<i>Alyssum markgrafii</i>	Krypesht
15.	<i>Alyssum smolikanum</i>	Serice smollkane
16.	<i>Alnus glutinosa</i> (ne shtrerte Lumenjeve)	Verri i zi
17.	<i>Alnus incana</i> (ne shtrerte Lumenjev)	Verri i eger
18.	<i>Alianthus glandulosa</i>	Arre Hindi
19.	<i>Allium meteoricum</i>	Qepe meteorike
20.	<i>Amorpha fruticosa</i>	Skербull
21.	<i>Amygdalus webbii</i>	Bajame e eger
22.	<i>Aquilegia amaliae</i>	Kanilqyqe e Amalise
23.	<i>Aquilegia dinarica</i>	Kanilqyqe Ginarike
24.	<i>Arabis allionii</i>	Arabez i Allionit
25.	<i>Arabis bryoides</i>	Arabez Srioid
26.	<i>Arabis serpillifolia</i>	Arabez i bores
27.	<i>Arabis scopoliana</i>	Arbez Skopolian
28.	<i>Arbutus andrachne</i>	Mellagjer
29.	<i>Arctostaphylos uva-ursi</i>	Rrush arushe
30.	<i>Aristolochia sempervirens</i>	Petrik perherblerte
31.	<i>Arenaria cretica</i>	Arenarie Kretase
32.	<i>Arenaria serpentina</i>	Arenarie serpentine
33.	<i>Arctostaphylos alpinus</i>	Rrush i alpeve
34.	<i>Asperula chlorantha</i>	Njegjire e blerte
35.	<i>Asperula scutellaris</i>	Njegjire shqytake
36.	<i>Aster albanicus</i>	Aster shqiptar
37.	<i>Astragalus autranii</i>	Arithe e Autranit
38.	<i>Asyneuma comosiforme</i>	Asineume balukengjashme
39.	<i>Astragalus baldaccii</i>	Arithe e Baldaçit
40.	<i>Athamanta densa</i>	Atamante e dendur

41.	<i>Athamanta macedonica</i>	Atamante e Shqiperise
42.	<i>Athamanta turbith</i>	Atamante e Hynaldit
43.	<i>Aubrieta intermedia</i>	Aubriete e ndermjetme
44.	<i>Barbarea balcana</i>	Barbare ballkanike
45.	<i>Berberis vulgaris</i>	Mylqine
46.	<i>Betula pendula</i>	Meshtekna
47.	<i>Biscutella laevigata</i>	Biskutela e sheshuar
48.	<i>Bornmuellera baldaccii</i>	Bornmylere e Baldaçit
49.	<i>Botrychium lunaria</i>	Sefir
50.	<i>Brassica incana</i>	Laker e zbardhur
51.	<i>Campanula albanica</i>	Lulekembane shqiptare
52.	<i>Campanula hawkinsiana</i>	Kambanore
53.	<i>Carduus cronicus</i>	Freshkulli i Baldaçit
54.	<i>Carduus kernerii</i>	Freshkulli i Sharrit
55.	<i>Carduus micropterus</i>	Freshkulli flaterngushte
56.	<i>Carduus ramosissimus</i>	Freshkull shume i degezuar
57.	<i>Carex markgrafii</i>	Presja e Markgrafit
58.	<i>Campanula tymphaea</i>	Lulekambane e Timfeut
59.	<i>Capparis spinosa</i>	Kaparine gjembore
60.	<i>Celtis tournefortii</i> (si lloj drusor)	Carac i Turnefortit
61.	<i>Celtis austriacalis</i> (si lloj drusor)	Carac
62.	<i>Centaurea candelabrum</i>	Kokoçel Kandelaber
63.	<i>Centaurea deustiformis</i>	Kokoçel si thengjill
64.	<i>Centaurea graeca</i>	Kokoçel i Greqise
65.	<i>Centaurea grisebachii</i>	Kokoçel i Grisebahut
66.	<i>Centaurea haynaldii</i>	Kokoçel i Hainaldit
67.	<i>Centaurea kosaninii</i>	Kokoçel i Koshaninit
68.	<i>Centaurea nicolai</i>	Kokoçel i Nikolasit
69.	<i>Centaurea pindicola</i>	Kokoçel i Pendit
70.	<i>Centaurea soskai</i>	Kokoçel i Soskit
71.	<i>Centaurea zuccariniana</i>	Kokoçel i Cukarinit
72.	<i>Cephalaria pastricensis</i>	Cefalarine e Pashtrikut
73.	<i>Cerastium grandiflorum</i>	Cerasti lulemadh
74.	<i>Cerasus avium</i>	Qershi e eger
75.	<i>Cerasus mahaleb</i>	Mezhdredhe
76.	<i>Ceratonia siliqua</i>	Xhixhibanoz
		Sterpuje e ngivrosur
77.	<i>Chaerophyllum coloratum</i>	Sterpuje e ngivrosur
78.	<i>Chaerophyllum heldreichii</i>	Sterpuje e Heldrahit
79.	<i>Chamaecytisus tommasinii</i>	Vjexhes i Tomasinit
80.	<i>Chelidonium majus</i>	Tamlagjak
81.	<i>Cirsium boujartii</i>	Cirze e Vetshtajnit
82.	<i>Cirsium tymphaeum</i>	Cirze e Timfeit
83.	<i>Cistus albanicus</i>	Menishte e Shqiperise
84.	<i>Colchicum autumnale</i>	Xherrokull vjeshtor
85.	<i>Colchicum cupanii</i>	Xherrokulli i Kupanit
86.	<i>Colchicum pinnatifidum</i>	Xherrokulli i Piperit

87.	<i>Colutea arborescens</i>	Fshikekarthe
88.	<i>Conium maculatum</i>	Kukute
89.	<i>Convallaria majalis</i>	Parlote
90.	<i>Cotoneaster tomentosa</i>	Borbull
91.	<i>Crataegus heldreichii</i>	Murrizi i Heldrahit
92.	<i>Crepis albanica</i>	Krepis shqiptar
93.	<i>Crepis baldaccii</i>	Krepis e Baldaçit
94.	<i>Crepis bertiscca</i>	Krepis Bertiskut
95.	<i>Crepis geracioides</i>	Krepis si kamarosh
96.	<i>Crepis turcica</i>	Krepis turke
97.	<i>Crocus boryi</i>	Shafran i Borit
98.	<i>Crocus dalmaticus</i>	Shafran i Dalmacise
99.	<i>Crocus scardicus</i>	Shafran i Sharrit
100.	<i>Cupressus sempervirens</i> (si lloj drusor)	Selvi
101.	<i>Cupressus sempervireus</i> var. <i>horizontalis</i> (si lloj drusor)	Qiparis horizontal
102.	<i>Cytisus agnipilus</i>	Vjexhes
103.	<i>Cytisus pseudoprocumbens</i>	Vjexhestor
104.	<i>Cypripedium calceolus</i> **	Lulepantofle
105.	<i>Daphne gnidium</i>	Hollokuq
106.	<i>Daphne mezereum</i>	Jargavan mali
107.	<i>Desmazeria marina</i>	Desmazere bregdetare
108.	<i>Dianthus viridescens</i>	Karafil ne te blerte
109.	<i>Dioscorea balcanica</i>	Groshe e eger
110.	<i>Dictamnus albus</i>	Dishel
111.	<i>Digitalis lanata</i>	Luletogez
112.	<i>Draba aspera</i>	Drabe e ashper
113.	<i>Draba korabensis</i>	Draba e Korabit
114.	<i>Draba parnassiaca</i>	Drabe e Parnosit
115.	<i>Dracunculus vulgaris</i>	Lulegjarper
116.	<i>Dryopteris filix-mas</i>	Fier mashkull
117.	<i>Edraianthus serpyllifolius</i>	Edraiant gjethlirse
118.	<i>Edraianthus wettsteinii</i>	Edraiant i Vetshtajnit
119.	<i>Eleagnus angustifolia</i>	Hunap
120.	<i>Ephedra distachya</i>	Gjunjeze
121.	<i>Erodium guicciardii</i>	Erode e Giçardit
122.	<i>Euphorbia dendroides</i>	Flom
123.	<i>Ficus carica</i> var. <i>caprificus</i>	Fik i eger
124.	<i>Frangula alnus</i>	Zogel, drunakuq
125.	<i>Fraxinus angustifolia</i> (si lloj drusor)	Frasher uji
126.	<i>Fraxinus excelsior</i> (si lloj drusor)	Frasher i zi
127.	<i>Fraxinus ornus</i> (si lloj drusor)	Frasher i bardhe
128.	<i>Fritillaria macedonica</i>	Luleene e Maqedonise
129.	<i>Fritillaria messanensis</i>	Luleene hollake
130.	<i>Galium degenii</i>	Ngjitese e Degenit
131.	<i>Galium firmum</i>	Ngjitese e qendrueshme

132.	<i>Galium intricatum</i>	Ngjitese e ngateruar
133.	<i>Galium procurrens</i>	Ngjitese e shpalosur
134.	<i>Gentiana lutea</i>	Saneza
135.	<i>Gentiana pneumonanthe</i>	Genciane e Nopçes
136.	<i>Geranium dalmaticum</i>	Kamaroshe e Dalmacise
137.	<i>Geum heterocarpum</i>	Melake fryndryshme
138.	<i>Goniolimon dalmaticum</i>	Goniolimon dalmatin
139.	<i>Gymnospermium shqipetarum</i>	Lule helmi
140.	<i>Halacsya sendtneri</i>	Halaç e Sendtnerit
141.	<i>Haplophyllum bioisieranum</i>	Haplofil shqiptar
142.	<i>Helichrysum plicatum</i>	Trendeline
143.	<i>Herniaria parnassica</i>	Hernarie e Parnasit
144.	<i>Hippophae rhamnoides</i>	Hipofae
145.	<i>Hutchinsia alpina</i>	Hutçinse alpine
146.	<i>Hyosciamus niger</i>	Metergone
147.	<i>Hypericum haplophylloides</i>	Lulebasan shqiptar
148.	<i>Ilex aquifolium</i>	Ashe
149.	<i>Jasminum fruticans</i>	Fule
150.	<i>Juglans regia</i> (ne gjendje te eger)	Arre
151.	<i>Juniperus excelsa</i>	Venja
152.	<i>Juniperus feotidissima</i>	Bersheni
153.	<i>Juniperus phoenicea</i>	Fidhes
154.	<i>Juniperus sabina</i>	Somine
155.	<i>Knautia visianii</i>	Knante e Visianit
156.	<i>Laburnum alpinum</i>	Ajdes
157.	<i>Laurus nobilis</i> (ne gjendje te eger)	Dafina
158.	<i>Leontopodium alpinum</i>	Ylli i alpeve
159.	<i>Leucojum valentinum</i>	Bilbilbardhe e Vlores
160.	<i>Ligusticum albanicum</i>	Vratik i Shqiperise
161.	<i>Limonum arfractum</i>	Fshese dredhake
162.	<i>Linum spathulatum</i>	Li pallak
163.	<i>Lotus cytisoides</i>	Thuepule vjexhengjashme
164.	<i>Lunaria telekiana</i>	Lunare e Telekit
165.	<i>Lycium europaeum</i>	Harvaline
166.	<i>Malcomia bicolor</i>	Malkolme dyngjyreshe
167.	<i>Malcomia illyrica</i>	Malkome ilire
168.	<i>Malus florentina</i>	Molle fiorentine
169.	<i>Malus sylvestris</i> (si lloj drusor)	Molle e eger
170.	<i>Malva nicaensis</i>	Mellage e Nices
171.	<i>Marsilea quadrifoli</i> **	Marsilie me kater gjethe
172.	<i>Marrubium alternidens</i>	Marub dhembekembyer
173.	<i>Marrubium cylleneum</i>	Marub i Kilenes
174.	<i>Matthiola tricupidata</i>	Pllake trimajse
175.	<i>Melampyrum doerfleri</i>	Grurezi i Dorflerit
176.	<i>Melampyrum heracleoticum</i>	Grurezi i Heraklese
177.	<i>Micromeria myrtifolia</i>	Bishtmi gjethemersine

178.	<i>Micromeria parviflora</i>	Bishtmi lulevogel
179.	<i>Minuartia baldaccii</i>	Minuarcia e Shkodres
180.	<i>Minuartia bosniaca</i>	Minuarcia e Bosnjes
181.	<i>Minuartia velenovski</i>	Minuarcia e Velenovskit
182.	<i>Moltkia doerfleri</i>	Moltke e Dorflerit
183.	<i>Narthecium scardicum</i>	Nartec i Sharrit
184.	<i>Nepeta parnassica</i>	Nepete e Parnasit
185.	<i>Nepeta spruneri</i>	Nepete e Sprunerit
186.	<i>Oenanthe tenuifolia</i>	Luledhri gjetheholle
187.	<i>Olea europea var. sylvestris</i>	Ulli i eger
188.	<i>Omalotheca pichleri</i>	Omaloteke e Pihlerit
189.	<i>Ononis spinosa</i>	Kalmuth
190.	<i>Orchis albanica</i>	Salep shqiptar
191.	<i>Orchis sp. divaricata</i>	Salep
192.	<i>Ostrya carpinifolia</i> (si lloj drusor)	Melleze
193.	<i>Oxytropis prenja</i>	Oksitrope e Prenjes
194.	<i>Oxytropis purpurea</i>	Oksitrop i purpurt
195.	<i>Paeonia mascula</i>	Lule bozhure
196.	<i>Pancratium maritimum</i>	Zambak i detit
197.	<i>Pedicularis brachydonta</i>	Pedikulare dhembeshkurter
198.	<i>Pedicularis graeca</i>	Pedikulare greke
199.	<i>Pedicularis leucodon</i>	Pedikulare dhembebardhe
200.	<i>Petasites doerfleri</i>	Llopua i Derflerit
201.	<i>Petteria ramentacea</i>	Grill
202.	<i>Peucedanum lavrentiadis</i>	Selin i Lavrentiadhit
203.	<i>Picea abies (excelsa)</i>	Hormoq
204.	<i>Pimpinella serbica</i>	Pimpinele e Serbise
205.	<i>Pinus mugo</i>	Kerleke
206.	<i>Pinus peuce</i>	Arn i bardhe
207.	<i>Pinus sylvestris</i>	Hartine
208.	<i>Pistacia lentiscus</i>	Xine
209.	<i>Pistacia terebinthus</i>	Bafer
210.	<i>Phillyrea angustifolia</i>	Mbrete
211.	<i>Phlomis herba-venti</i>	Bezge barere
212.	<i>Phyteuma pseudorbicularis</i>	Fiteume rrotullare e rreme
		Gjethedell si veshke
213.	<i>Plantago reniformis</i>	Gjethedell si veshke
214.	<i>Polygala doerfleri</i>	Poligale e Dorflerit
215.	<i>Polygonum albanicum</i>	Nejce shqiptare
216.	<i>Potentilla visianii</i>	Zorrec i Visianit
217.	<i>Prunus cerasifera</i> (si lloj drusor)	Kumbull kokervogel
218.	<i>Prunus cocomilia</i> (si lloj drusor)	Kumbull e eger
219.	<i>Prunus spinosa</i>	Kulumbri
220.	<i>Pterocephalus perennis</i>	Pterocefal shumevjeçar
221.	<i>Ptilotrichum cyclocarpum</i>	Ptilotrik frytrrethor
222.	<i>Pinguicula crystalina</i>**	Pinguikula
223.	<i>Pulsatilla halleri</i>	Pulsatille e Hallerit

224.	<i>Punica granatum</i> (si lloj drusor)	Shege e eger
225.	<i>Pyracantha coccinea</i>	Ushinth
226.	<i>Pyrus amygdaliformis</i> (si lloj drusor)	Gorrice
227.	<i>Pyrus communis</i> (si lloj drusor)	Gorrice e eger
228.	<i>Quercua crenata</i>	Shurdhi
229.	<i>Quercus ilex</i>	Ilqe
230.	<i>Quercus robur</i>	Rrenje
231.	<i>Ramonda serbica</i>**	Ramonde e Serbise
232.	<i>Ranunculus brevifolius</i>	Zhabine gjetheshkurter
233.	<i>Ranunculus degenii</i>	Zhabine e Degenit
234.	<i>Ranunculus fontanus</i>**	Zhabine fontane
235.	<i>Ranunculus hayekii</i>	Zhabine e Hajekut
236.	<i>Ranunculus scutatus</i>	Zhabine shqytake
237.	<i>Ranunculus wettsteinii</i>	Zhabine e Vetshtajnit
238.	<i>Ribes multiflorum</i>	Ribez shumelulese
239.	<i>Rhamnus intermedius</i>	Pjerez e ndermjeme
240.	<i>Rhinanthus melampyroides</i>	Taklline gruzezi
241.	<i>Ruscus hypoglossum</i>	Rrushkull nengjuhez
242.	<i>Salix hastata</i>	Shelg heshtak
243.	<i>Salix reticulata</i>	Shelg fleterrjete
244.	<i>Salix waldsteiniana</i>	Shelg i Valdshteinit
245.	<i>Salvia candidissima</i>	Sherebele shume e bardhe
246.	<i>Sambucus nigra</i>	Shtog i zi
247.	<i>Sambucus racemosa</i>	Shtog i kuq
248.	<i>Sanguisorba albanica</i>	Lulekomisht shqiptar
249.	<i>Sarcopoterium spinosum</i>	Dorevate
250.	<i>Saxifraga scardica</i>	Iriqez e Sharrit
251.	<i>Saxifraga sedoides</i>	Iriqez e Prenjit
252.	<i>Schinus molle</i>	Skinus
253.	<i>Scrophularia bosniaca</i>	Sarushe boshnjake
254.	<i>Sedum serpentini</i>	Rrush guresh
255.	<i>Sempervivum ciliatum</i>	Burgull e qerpiket
256.	<i>Senecio thapsoides</i>	Pulith si netull
257.	<i>Serratula radiata</i>	Serratule rrezake
258.	<i>Sesleria paparistoi</i>	Pirre e Paparistos
259.	<i>Sesleria robusta</i>	Pirre e Skenderbeut
<hr/>		
260.	<i>Sesleria wettsteinii</i>	Pirre e Vetshtajnit
261.	<i>Sideritis raeseri</i>	Çaj mali
262.	<i>Silene caesia</i>	Klokeze e kalterreme
263.	<i>Silene macrantha</i>	Klokeze lulemadha
264.	<i>Silene pindicola</i>	Klokeze e Pindit
265.	<i>Silene schwarzenbergeri</i>	Klokeze e Shvarcenbergut
266.	<i>Silene tommasinii</i>	Klokeze e Tomazinit
267.	<i>Sinapis pubescens</i>	Sinap pushor
268.	<i>Soldanella dimonieii</i>	Pratish i Dimomeit
269.	<i>Solananthus albanicus</i>**	Solenante e Shqiperise

270.	<i>Sorbus aucuparia</i>	<i>Vadhez e eger</i>
271.	<i>Stachys albanica</i>	<i>Sarushe e Shqiperise</i>
272.	<i>Stachys beckeana</i>	<i>Sarushe e Bekeit</i>
273.	<i>Stachys decumbens</i>	<i>Sarushe e shtrire</i>
274.	<i>Stachys menthifolia</i>	<i>Sarushe gjethemender</i>
275.	<i>Styrax officinalis</i>	<i>Ftua i eger</i>
276.	<i>Symphytum officinale</i>	<i>Kufilme mjekesore</i>
277.	<i>Tanacetum cinerariifolium</i>	<i>Barmize, Karapjel</i>
278.	<i>Taxus baccata</i>	<i>Tis</i>
279.	<i>Teucrium arduini</i>	<i>Arrs i Arduinit</i>
280.	<i>Teucrium fruticans</i>	<i>Arrs shkurrak</i>
281.	<i>Thesium auriculatum</i>	<i>Armire bulezore</i>
282.	<i>Thlaspi microphyllum</i>	<i>Tlasp gjethevogel</i>
283.	<i>Trapa natans**</i>	<i>Arre uji</i>
284.	<i>Trifolium pilezii</i>	<i>Trifil i Pileit</i>
285.	<i>Trifolium wettsteinii</i>	<i>Trifil i Vetshtajnit</i>
286.	<i>Trollius europaeus</i>	<i>Trol evropian</i>
287.	<i>Typha shkuttleworthi**</i>	<i>Shavari i Shutlevorthit</i>
288.	<i>Ulmus glabra</i>	<i>Hidhes</i>
289.	<i>Vaccinium myrtillus</i>	<i>Boronice</i>
290.	<i>Vaccinium uliginosum</i>	<i>Legjithe</i>
291.	<i>Vaccinium vitis-idaea</i>	<i>Trasheger e malit</i>
292.	<i>Valantia aprica</i>	<i>Valancie e shullerit</i>
293.	<i>Valeriana bertiscea</i>	<i>Haraqine e Bertiskut</i>
294.	<i>Valeriana crinii</i>	<i>Haraqine e Krinit</i>
295.	<i>Valeriana officinalis</i>	<i>Haraqine mjekesore</i>
296.	<i>Valeriana saxatilis</i>	<i>Haraqine e Pançiqit</i>
297.	<i>Verbascum guicciardi</i>	<i>Netull e Giçardit</i>
298.	<i>Verbascum nicolai</i>	<i>Netull e Nikollait</i>
299.	<i>Verbascum vandasii</i>	<i>Netull e Vandasit</i>
300.	<i>Veronica saturejoides</i>	<i>Veronike trumzengjashme</i>
301.	<i>Viburnum tinus</i>	<i>Butine</i>
302.	<i>Viola beckiana</i>	<i>Vjollca e Bekut</i>
303.	<i>Viola elegantula</i>	<i>Vjollca pak e hijeshme</i>
304.	<i>Viola kosaninii</i>	<i>Manushaqe e Koshaninit</i>
305.	<i>Viola speciosa</i>	<i>Manushaqe e bukur</i>
306.	<i>Vincetoxicum huteri</i>	<i>Qenmbytese e Huterit</i>
307.	<i>Wulfenia baldaccii</i>	<i>Vulfenia e Badaçit</i>
308.	<i>Wulfenia carinthiaca</i>	<i>Vulfenia e Karintise</i>

** Llojet te cilat perfshihen ne Aneksin 1 te Konventes se Bernes.

Shenim: Per perpilimin e listes se bimeve te kercenuara dhe te rralla te flores se Shqiperiise DPPK eshte mbeshtetur ne:

1. Aneksin I te konventes "Per ruajtjen e flores dhe te faunes se eger dhe mjedisin natyror te Europes";
2. "Libri i Kuq", "Bimet e kercenuara dhe te rralla te Shqiperise", me autor J.Vangjeli, B.Ruci dhe A. Mullaj; botim ivitit 1994, Akademise se Shkencave, IKB dhe Komitetit te Mbrojtjes se mjedisit;
3. Propozimet e DSHPygor te rretheve shtator 2002.
4. Shenimi(*si lloj drusor*),ndalon prerjen si dru por lejohet vjelja e frutave ose gjetheve.
5. Shenimi (*ne gjendje te eger*)ndalon prerjen ose vjeljen e frutave ose gjetheve ne arealin e perhapjes natyrale, por jo ne plantacionet e kultivuara.
6. Shenimi(*ne shtreter te lumenjeve*) ndalon prerjen ose vjeljen e frutave,levores ose gjetheve brenda kesaj zone te perhapjes natyrale

VENDIM

Nr.805, datë 4.12.2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEPRIMTARIVE QË NDIKOJNË NË MJEDIS, PËR TË CILAT KËRKOHET LEJE MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 36 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Aneksi 1

1. INDUSTRIA ENERGJETIKE

1.1 Rafineritë e naftës dhe të gazit, lëngëzimi dhe përpunimi i qymyrit dhe rërave bituminoze, impiante për rigjenerimin e vajrave të përdorura

1.2 Impiante industriale për prodhimin e energjisë, avullit dhe ujit të nxehtë

1.3 Reaktorët bërthamorë

1.4 Impiante për prodhimin ose pasurimin e lëndëve djegëse bërthamore, për ripërpunimin e lëndëve djegëse bërthamore të rrezatuara ose për ruajtje, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve radioaktive

1.5 Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies

1.6 Impiantet e përpunimit të naftës dhe të gazit

1.7 Uzina për gazifikimin dhe lëngëzimin e qymyrit dhe rërave bituminoze

1.8 Impiantet për gazifikimin dhe lëngëzimin nga lëndë djegëse të ngurta

1.9 Hidrocentrale

1.10 Centralet e shfrytëzimit të energjisë së erës

1.11 Impiantet industriale për transferimin e gazit, avullit dhe ujit të nxehtë, impiante industriale për transferimin e energjisë elektrike me kablllo ajrore

1.12 Depozita të mëdha për magazinimin për qëllime tregtimi apo ruajtje për naftën, nënproduktet e naftës dhe produktet kimike

1.13 Ruajtja në sipërfaqe e gazit natyror

1.14 Ruajtja nëntokë e gazeve të djegshme

1.15 Impiantet e briketimit të lëndëve djegëse të ngurta dhe minerale

2. PRODHIMI DHE PËRPUNIMI I METALEVE

2.1 Uzina të shkrirjes së mineraleve (duke përfshirë mineralet që përmbajnë squfur)

2.2 Kalcinimi dhe pjekja e mineraleve që përmbajnë elemente toksike

2.3 Uzinat për prodhimin e gizës dhe çelikut (bashkimi primar ose sekondar), duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme

2.4 Uzinat ose fonderitë për përpunimin e metaleve të hekurit:

a) uzina të petëzimit;

b) kovaçhana me çekiçë;

c) aplikimi i veshjeve mbrojtëse me metal të përzier.

2.5 Fonderi të metaleve të hekurit

2.6 Fonderi ose uzina për:

a) prodhimin e metaleve me ngjyra dhe metaleve joferrike nga mineralet, koncentratet ose lëndët dytësore të proceseve metalurgjike, kimike, elektrolitike;

b) shkrirjen, përfshirë përzierjen e metaleve me ngjyrë, përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi etj.).

2.7 Uzina për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik

2.8 Prodhimi i hekurit të kuq dhe çelikut me derdhje të vazhdueshme:

a) impiantet për përpunimin e metaleve të hekurit;

b) fonderi të metaleve të hekurit;

c) shkrirjen, duke përfshirë përzierjen e metaleve me ngjyrë, përfshirë produktet e rikuperuara (rafinimi, derdhja në fonderi etj.);

d) impiantet për trajtimet sipërfaqësore të metaleve dhe materialeve plastike;

e) prodhimi dhe montimi i automjeteve dhe prodhimi i motorëve për automjete;

f) kantiere detare;

g) impiante për pjekjen dhe sinterimin e mineraleve metalike;

h) impiante për prodhimin dhe riparimin e avionëve;

i) prodhimi i pajisjeve hekurudhore;

j) punimet që përdorin eksploziv.

2.9 Shfrytëzimi i minierave të mineraleve metalore

2.10 Fabrika e pasurimit të mineraleve

3. NXJERRJA DHE PËRPUNIMI I MATERIALEVE BAZË, QË NUK KANË NË PËRBËRJE MINERALE XEHERORE

3.1 Prodhimi dhe përpunimi i aliazheve për metale joferrike

3.2 Nxjerrja dhe përpunimi i qymyrit, linjitit dhe mineraleve bitumene

3.3 Nxjerrja e naftës

3.4 Nxjerrja e gazit natyror për qëllime tregtimi

3.5 Impiante të prodhimit të çimentos

3.6 Impiante të prodhimit të gëlqeres

3.7 Fabrika për prodhimin e qelqit, përfshirë fibrat e xhamit

3.8 Fonderi për shkrirjen e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale

3.9 Fabrika për prodhimin e prodhimeve qeramike me pjekje, e në veçanti tjegulla, tulla, tulla refraktare ose porcelani

3.10 Guroret dhe minierat e hapura të argjileve ose nxjerrja e torfës

3.11 Nxjerrja e mineral-inerteve nga drenazhimi detar dhe lumor

3.12 Shpimet e thella, në veçanti:

- a) shpimet gjeotermike;
- b) shpime të kërkimit të naftës dhe gazit;
- c) për depozitim të mbetjeve dhe mbetjeve bërthamore;
- d) shpimet për furnizimet me ujë, duke përjashtuar shpimet për të kontrolluar qëndrueshmërinë e tokës.

3.13 Objekte sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit natyror, si dhe të rërës bituminoze

3.14 Vepra të integruara për shkrirjen fillestare të gëzës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve joferrike, ato që nuk janë të përfshira në aneksin 1

4. INDUSTRIA KIMIKE

Vepra të integruara për prodhimin në shkallë industriale të substancave ose grupeve të substancave të listuara në seksionet 4.1-4.8 me anë të proceseve kimike.

4.1 Për prodhimin e kimikateve organike bazë, të tilla si:

- a) hidrokarbure të thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura ose të pangopura, alifatike ose aromatike);
- b) hidrokarbure që përmbajnë oksigjen, të tilla si: alkoolike, aldehide, ketone, acide karboksilike, etere, acetone, peroksido, rrëshirë;
- c) hidrokarbure sulfurike;
- d) hidrokarbure të azotit, të tilla si: amine, amide, përbërës të azotit, përbërës të nitrarit, nitrile, sianete, izocianate;
- e) hidrokarbure që përmbajnë fosfor;
- f) hidrokarbure halogjene;
- g) përbërës organo-metalikë;
- h) materiale plastike bazë (polimere, fibra sintetike dhe fibra me bazë celuloze);
- i) goma sintetike;
- j) ngjyrosës dhe pigmente;
- k) agjentë aktivë sipërfaqësorë dhe sipërfaqësues.

4.2 Për prodhimin e:

- a) gazeve;
- b) acideve;
- c) bazave;
- d) metaloideve dhe përbërjet e tyre;
- e) metaleve dhe përbërjet e tyre.

4.3 Për prodhimin e plehrave me bazë fosfatike ose fosfatike azotike (plehra të thjeshta ose të përbëra)

4.4 Për prodhimin e produkteve me bazë bimore dhe të biocideve

4.5 Impiantet që përdorin proceset kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve me bazë farmaceutike, bojërave dhe pesticideve (prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojërave dhe varakut, elastomeres dhe peroksido)

4.6 Impiante kimike për prodhimin e lëndëve shpërthyes

4.7 Impiantet kimike që prodhojnë shtesa ushqimore proteinike, fermente dhe substanca të tjera proteinike me rrugë kimike ose biologjike

4.8 Trajtimi i produkteve të ndërmjetme dhe prodhimi i kimikateve

5. INDUSTRIA USHQIMORE

5.1 Prodhimi i vajrave dhe yndyrave shtazore dhe bimore

5.2 Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore

5.3 Prodhimi i produkteve bulmetore

5.4 Prodhimi i birrës

5.5 Prodhimi i shurpeve dhe ëmbëlsirave

5.6 Fabrikat për peshkun dhe vajin e peshkut

5.7 Fabrikat e sheqerit

5.8 Prodhimi i pijeve joalkoolike

5.9 Trajtimi dhe përpunimi i synuar për prodhimin e produkteve ushqimore nga:

- a) lëndët e para me origjinë shtazore (me përjashtim të qumështit);
 - b) lëndët e para bimore;
 - c) trajtimi dhe përpunimi i qumështit;
- 6. INDUSTRIA TEKSTILE E LËKURËVE, DRURIT DHE LETRËS**
- 6.1 Prodhimi i fibrave të kartonit nga druri ose materiale me fibra të ngjashme
- 6.2 Impiante industriale për:
- a) prodhimin e pulpës nga lëndët drusore ose fibrave të tjera të ngjashme;
 - b) prodhimin e letrës dhe kartonëve.
- 6.3 Impiante për paratrajtimin (larja, zbardhja, mercerizimi) ose lyerja e fibrave dhe tekstileve
- 6.4 Impiante për trajtimin e lëkurëve dhe thundrave
- 6.5 Impiante për përpunimin dhe prodhimin e celulozës
- 6.6 Prodhimi i mobiljeve
- 7. INDUSTRIA E GOMËS**
- 7.1 Prodhimi dhe përpunimi i produkteve me bazë rezinash natyrore dhe sintetike
- 8. ADMINISTRIMI I MBETJEVE**
- 8.1 Impiante për asgjësimin ose përpunimin e mbetjeve të rrezikshme ose neutralizimin e naftës së përdorur, që kryejnë një ose më shumë prej aktiviteteve të mëposhtme:
- 8.1.1 Neutralizimin e mbetjeve të rrezikshme
- 8.1.2 Një ose më shumë prej aktiviteteve të mëposhtme për përpunimin e mbetjeve të rrezikshme:
- a) rafinimin, rikuperimin e solventeve;
 - b) rikuperimin e bazave dhe acideve;
 - c) ripërdorimin e përbërësve të përdorur për reduktimin e ndotjeve;
 - d) rafinimin e përsëritur ose ripërdorimin e naftës dhe produkteve të saj; përdorimin si lëndë djegëse apo mënyra të tjera për prodhimin e energjisë.
- 8.2 Impiante për djegien e mbeturinave urbane
- 8.3 Impiante për asgjësimin e mbeturinave jo të rrezikshme, përfshirë mbetjet e industrisë dhe ato urbane që kryejnë aktivitetet e mëposhtme:
- 8.3.3 Trajtimin biologjik, produktet ose përzierjet përfundimtare të të cilit duhet të neutralizohen
- 8.3.4 Trajtimin fiziko-kimik (si avullimi, tharja, kalcifikimi, etj.), produktet ose përzierjet përfundimtare të të cilit duhet të neutralizohen
- 8.4 Vendgroposjet (landfillet)
- 8.5 Vendet e depozimit të mbetjeve industriale
- 8.6 Vendet e depozitimit të inerteve, nga prishjet e godinave etj.
- 9. AKTIVITETE TË TJERA**
- 9.1 Rrugë permanente që përdoren për testimin dhe garat e mjeteve të motorizuara
- 9.2 Depot për ruajtjen e mbeturinave të hekurit, duke përfshirë skeletet metalike të makinave të dala jashtë përdorimit
- 9.3 Impiante për testimin e motorëve, turbinave dhe reaktorëve
- 9.4 Impiante për rikuperimin dhe shkatërrimin e lëndëve eksplozive
- 9.5 Impiante për therjen e kafshëve (thertore)
- 9.6 Instalimet për prodhimin e fibrave minerale artificiale
- 9.7 Instalimet për rikuperimin ose shkatërrimin e substancave eksplozive
- 9.8 Impiantet për rritjen intensive të shpendëve, derrave e bagëtive të imta
- 9.9 Impiantet e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane
- 9.10 Vendet që përdoren për grumbullimin e kafshëve të ngordhura ose të padëshirueshme
- 9.11 Impiant për depozitimin ose riqarkullimin e mbeturinave të kafshëve dhe skeleteve të kafshëve
- 9.12 Impiant për trajtimin sipërfaqësor të substancave, objekteve ose produkteve që përdorin solvente organike, në veçanti për veshje, printim, mbiveshje, çyndyrësim, kundër depërtimit të ujit, bojërave, pastrim ose ngjeshje

9.13 Projekte të fushës së mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si: qendra stërvitore, depo armatim-municioni, poligone qitje, depo armatimesh, depo lëndësh kimike etj.

9.14 Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura:

a) projekte për restaurimin e zonave rurale;

b) projekte për përdorimin e tokave jobujqësore ose zonave gjysmë natyrore, për qëllime të bujqësisë intensive;

c) projekte të menaxhimit të ujërave për nevoja bujqësore, duke përfshirë projektet e vaditjes dhe drenazhimit të tokës;

d) pyllëzimi dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të tokës;

e) fermat e peshkimit;

f) marrja e tokës nga deti;

g) rregullimet e lumenjve.

9.15 Projektet e infrastrukturës:

a) projekte të zhvillimit industrial;

b) projekte të zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave të blerjes dhe parkimet e automjeteve;

c) ndërtimi i linjave hekurudhore, faciliteteve të transportit të kombinuar dhe të terminaleve intermodale (mikse);

d) ndërtimi i aeroporteve dhe fushave për avionë;

e) ndërtimi i rrugëve (ndërtimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi i rrugëve ekzistuese);

f) ndërtimi i porteve dhe instalimeve portuale, duke përfshirë edhe portet e peshkimit;

g) ndërtimi i rrugëve ujore në brendësi të tokës dhe portet për trafikun ujor në brendësi të tokës;

h) portet e tregtimit, molet për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën ose porte të jashtme;

i) ndërtimi i tramvajeve, ashensorëve dhe hekurudhave të nëndheshme, të përdorura vetëm ose kryesisht për transport pasagjerësh;

j) punimet për kanalizimet e ujërave të zeza dhe shkarkimet e ujërave të përmytjeve;

k) impiante të trajtimit të ujërave të zeza;

l) dampat dhe rezervuarët e tjerë të projektuar për të mbajtur ujë ose për ta ruajtur atë për një kohë të gjatë;

m) ndërtimi i ujësjellësve;

n) puna në bregdet kundër erozionit dhe punimet që do të ndryshojnë bregdetin gjatë ndërtimit, si p.sh. molet dhe punime të tjera mbrojtëse në dete, duke përjashtuar mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e punimeve të tilla;

o) nxjerrja e ujërave nëntokësore dhe skemat e rimbushjes artificiale të ujërave nëntokësore;

p) projekte për transferimin e burimeve ujore midis baseneve të lumenjve;

q) akuadukte.

9.16 Turizmi dhe koha e lirë:

a) teleferikët e skive, makina me kablllo dhe zhvillime të shoqëruara me këto lloj veprimtarish;

b) portet turistike;

c) fshatra turistike dhe komplekset e hoteleve jashtë zonave urbane dhe të zhvillimeve të shoqëruara me këto lloj veprimtarish;

d) vendet (zona) e karvaneve dhe kampeve;

e) parqet zbavitëse.

9.17 Punimet me rrezatimet elektromagnetike jojonizuese, si dhe sistemet e transmetimit.

VENDIM
Nr.806, datë 4.12.2003

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE E TË PROCEDURAVE PËR IMPORTIMIN E
MBETJEVE PËR PËRDORIM, PËRPUNIM E RICIKLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Importimi i mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim

1. Personat fizikë dhe juridikë mund të importojnë mbetje për t'i përdorur, përpunuar e ricikluar, me përjashtim të mbetjeve të rrezikshme, importimi i të cilave rregullohet me dispozita të veçanta, vetëm në kushtet kur:

a) përdorimi, përpunimi e riciklimi i tyre kryhet me teknologji bashkëkohore, që garanton mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit;

b) prej tyre përfitohen lëndë ose materiale të dobishme dhe kursehen lëndë të para, deficitare dhe të kushtueshme;

c) transportimi i tyre nuk ndikon negativisht në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin e tyre.

2. Importimi i mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim mund të kryhet vetëm pasi personi fizik ose juridik që kërkon t'i importojë, të jetë i pajisur me miratimin përkatës.

3. Miratimi për importimin e mbetjeve jepet nga Këshilli i Ministrave, duke përcaktuar llojin e sasinë që do të importohet dhe afatet e importimit.

4. Për të marrë miratimin për importimin e mbetjeve, personi fizik ose juridik, paraqet këto dokumente:

a) Kërkesën për të lejuar importin e këtyre mbetjeve.

b) Deklaratën personale, ku përcaktohen emërtimi i mbetjes, sasia, përbërja, destinacioni, lloji i veprimtarisë ku do të përdoret, si dhe respektimi i kërkesave ligjore, i normave e i standardeve për mbrojtjen e mjedisit.

c) Fotokopjen e noterizuar të licencës me të cilën është miratuar veprimtaria nga organi përkatës shtetëror.

ç) Fotokopjen e noterizuar të lejes mjedisore, në të cilën janë përcaktuar kushtet e ushtrimit të veprimtarisë.

d) Fotokopjen e noterizuar të lejes së dhënë nga Ministria e Shëndetësisë, ku përcaktohen kushtet në mbrojtje të shëndetit të publikut.

dh) Mendimin me shkrim të organit të qeverisjes vendore, në bazë të të cilit është rënë dakord që, në territorin e tij, të përpunohen mbetje të importuara.

Dokumentet e paraqitura pranohen dhe regjistrohen në protokollin e Ministrisë së Mjedisit, pasi kërkuesi të ketë derdhur, në llogarinë rrjedhëse të tij, tarifën e shërbimit në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

5. Ministria e Mjedisit, në bazë të studimit dhe të verifikimit në vend të veprimtarisë, jep mendimin për kërkesën dhe, brenda 20 ditëve nga regjistrimi i saj në protokoll, ia përcjell të gjitha dokumentet Këshillit të Ministrave.

6. Kur kërkesa pranohet, Ministria e Mjedisit harton projektvendimin për importimin e mbetjeve të kërkuara dhe ia dërgon për miratim Këshillit të Ministrave. Kur kërkesa refuzohet Ministria e Mjedisit harton projektvendimin që refuzon kërkesën.

7. Ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave, që nuk miraton kërkesën për importimin e mbetjeve, kërkuesi, brenda 30 ditëve, mund të ankohet në gjykatë.

8. Ministria e Mjedisit mban regjistër të veçantë për kërkesat për importimin e mbetjeve, në të cilin shënohen kërkesa, emri i kërkuesit, lloji, sasia e mbetjes, destinacioni, miratimi ose refuzimi i saj.

9. Përdorimi, përpunimi dhe riciklimi i mbetjeve të importuara përfaqësojnë veprimtari të veçantë nga importimi i tyre dhe personi fizik ose juridik pajiset me leje mjedisore, sipas kërkesave të ligjeve nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” dhe nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

II. Transporti i mbetjeve që importohen

1. Për mbetjet që do të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë importuesi siguron, kundrejt kontratës së transportit, ambalazhimit, ngarkimit, transportit dhe shkarkimit të tyre, për të mos shkaktuar ndikime negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.

2. Për të bërë transportin e mbetjeve, personi importues, juridik ose fizik, duhet të marrë nga institucionet e autorizuar të vendit të prejardhjes së mbetjes:

- a) deklaratën e konfirmimit të llojit dhe të përbërjes së mbetjes;
- b) certifikatat, që tregojnë se mbetja nuk përbën rrezik për shëndetin dhe mjedisin;
- c) lejen e organeve doganore të vendit nga importohet.

3. Personi juridik ose fizik, importues i mbetjeve, është i detyruar të ketë në kontratën e transportit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar, si dhe ato që parashikohen në pikën II/2 të këtij vendimi. Dokumentet e transportit shoqërojnë ngarkesën gjatë gjithë kohës së transportit, deri në vendin e shkarkimit.

III. Kontrolli doganor

1. Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e mjeteve të transportit të ngarkuara me mbetje lejohet nga organet doganore vetëm pasi, në zbatim të Kodit Doganor dhe të vendimit nr.205, datë 13.3.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, u paraqitet edhe kopja e vendimit të Këshillit të Ministrave, që ka miratuar importimin, si dhe dokumentet e parashikuara në pikën II/2 të këtij vendimi.

2. Organet doganore të pikave kufitare, të përcaktuara në pikën III/3 të këtij vendimi, mbajnë regjistër të veçantë për mbetjet që futen në vendin tonë, ku shënojnë llojin e mbetjes, sasinë, importuesin, vendin e shkarkimit.

3. Për hartimin e raportit të gjendjes së mjedisit, organet doganore, në fund të çdo viti, raportojnë në Ministrinë e Mjedisit të dhënat për llojin e mbetjes, sasinë, importuesin dhe vendin e shkarkimit.

IV. Pikat 10, 11,12 dhe 13 të vendimit nr.26, datë 21.1.1994 të Këshillit të Ministrave “Për mbetjet e rrezikshme dhe mbeturinat”, shfuqizohen.

V. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM Nr.807, datë 4.12.2003

PËR RREGULLAT E DHËNIES NË PËRDORIM TË SHPELLAVE

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 pika 4 dhe 33 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e rregullave për dhënien në përdorim të shpellave për t'u vizituar, për qëllime shkencore, ekologjike, kulturore, historike, turistike, kurative, didaktike e fetare, duke u kujdesur që të mos dëmtohen vlerat e tyre.

1. Shpellat mund të jepen në përdorim vetëm pasi të jenë përgatitur për veprimtaritë e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi.

2. Përgatitja e shpellës për përdorim bëhet veçmas për secilën prej tyre dhe nënkupton ndërhyrjet e veprimet mbrojtëse e restauruese, ngritjen e infrastrukturës, sistemet e kalimit, të ndriçimit, të kullimit të ujërave e të ventilimit, krijimin e mjedisëve muzeale të njeriut të shpellave e të kafshëve të hershme.

3. Përgatitja e shpellës për përdorim bëhet sipas një projekti, që ka parasysh karakteristikat dhe përbërësit individualë të çdo shpelle. Ky projekt miratohet nga Ministri i Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave, me institutet shkencore përkatëse dhe me OJF-të e specializuara.

4. Projekti zbatohet nga subjekte publike ose private, që do të përzgjidhen sipas procedurave të tenderimit dhe që veprojnë nën mbikëqyrjen e agjencive rajonale të mjedisit, të administratës së zonës së mbrojtur dhe të strukturave përkatëse të turizmit e të pushtetit vendor.

5. Një shpellë mund të jepet në përdorim kur:

a) është shpallur monument natyror;

b) institutet kërkimore-shkencore përkatëse kanë dhënë me shkrim deklaratën se ka përfunduar eksplorimi dhe studimi i saj;

c) ka përfunduar përgatitja e saj për t'u dhënë në përdorim;

ç) Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit e me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave, e kanë shpallur atë në listën e shpellave që mund të jepen në përdorim, pas klasifikimit të bërë nga komisioni i posaçëm.

6. Për t'u pajisur me leje mjedisore për përdorimin e shpellës, subjekti publik ose privat përgatit këto dokumente:

a) kërkesën për t'u pajisur me leje mjedisore për përdorimin e shpellës, drejtuar Ministrisë së Mjedisit;

b) fotokopjen e noterizuar të vendimit të gjykatës që e ka regjistruar si person fizik ose juridik dhe dokumentacionin e nevojshëm nga organet tatimore dhe gjyqësore për mospasje të detyrimeve ndaj tyre;

c) përshkrimin e hollësishëm të veprimtarisë që do të ushtrojë në shpellë;

ç) deklaratën personale, me anën e së cilës deklaroi se siguron mbrojtjen e vlerave të shpellës, mirëmbajtjen e saj, me shpenzimet e veta, ruajtjen e mikroklimës, të regjimit ujqor, të ekosistemeve, të tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike dhe të gjallesave.

7. Leja mjedisore miratohet nga Ministri i Mjedisit, i cili përcakton kushtet dhe rrethanat për përdorimin e shpellës dhe synon ruajtjen e gjendjes natyrore dhe të vlerave të saj. Leja mjedisore është e vlefshme për tre vjet, por mund të përtërihet edhe pas këtij afati.

8. Personi fizik ose juridik, që merr në përdorim një shpellë, paguan tarifën vjetore të përdorimit të saj, e cila përbëhet nga pjesa fikse prej 200 000 lekësh dhe pjesa e lëvizshme, që përfaqëson një të dhjetën e shpenzimeve të bëra për përgatitjen për dhënien për përdorim të saj. Tarifa derdhet në llogarinë e komunës ku ndodhet shpella dhe përdoret për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit që ka në juridiksion.

9. Personi fizik ose juridik, që merr leje për përdorimin e shpellës, lidh kontratë me komunën ku ndodhet ajo. Në kontratë përcaktohen koha e përdorimit dhe detyrimet e palëve, sipas kërkesave të Kodit Civil, të këtij vendimi dhe të kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore.

10. Kur shpella që do të jepet në përdorim ndodhet në një territor pronë private, përgatitja dhe shpallja e saj për t'u dhënë në përdorim bëhen në marrëveshje me pronarin e tokës ku ndodhet shpella. Në këtë rast, është pronari i pari që mund të marrë shpellën në përdorim, me kusht që të zbatojë kërkesat e këtij vendimi.

11. Subjekti publik ose privat, që ka marrë në përdorim një shpellë, nuk mund t'ia japë atë një personi tjetër ose të ndryshojë destinacionin e përdorimit.

12. Inspektorati i Mjedisit dhe administrata përkatëse e zonës së mbrojtur kontrollojnë përdorimin e shpellës, në përputhje me kërkesat e ligjit "Për zonat e mbrojtura" dhe me kushtet e

përcaktuara në lejen mjedisore.

13. Kur Inspektorati i Mjedisit ose administrata përkatëse e zonës së mbrojtur vëren se përdorimi rrezikon shpellën dhe vlerat e saj, merr masa dhe ndëshkon përdoruesin, në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi. Kur Inspektorati i Mjedisit vëren dëmtime të shpellës, mbyll veprimtarinë, duke ia hequr përdoruesit lejen e përdorimit të shpellës, si dhe urdhëron pagimin e shpenzimeve për riparimin e dëmeve.

14. Ndaj vendimit të Inspektoratit të Mjedisit, përdoruesi mund të ankohet te Ministri i Mjedisit, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Ndaj vendimit të Ministrisë të Mjedisit apo dhe në rastet kur ky i fundit nuk është përgjegjës në afatin e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative mund të bëhet ankim gjyqësor, sipas ligjeve në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.808, datë 4.12.2003

PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me leje manovrimi.

2. Ngritjen e komisionit të posaçëm për dhënien e lejeve të manovrimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të këtij komisioni bëhen me urdhër të Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

3. Organizimi e funksionimi i komisionit të posaçëm, si dhe kushtet, kriteret e dhënies së lejes së manovrimit, lloji i makinës që e përfiton këtë leje e disiplinimi i përdorimit të këtyre makinerive të përcaktohen në rregulloren që do të hartohet në bashkëpunim me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, e që do të miratohet nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

4. Kurset teorike e praktike për përgatitjen e manovruesve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike që kanë në përdorim këto makineri, me autorizim të Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin këto subjekte juridike do të përcaktohen në rregulloren e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi.

6. Përdorimi i makinerive të rënda pa lejen e manovrimit përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.

7. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.809, datë 4.12.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I URËS SË RE, BOGOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i urës së re, Bogovë, ndërtim i cili ka filluar në shtator të vitit 2003 dhe do të përfundojë brenda katër muajsh.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për tre objekte, me sipërfaqe 260 m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 4 534 850 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 116 700 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind) lekësh.
5. Fondi prej 4 651 550 (katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh për kompensimin e pronarëve dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.12.2003.
7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT

Lista e pronarëve që shpronësohen, si rezultat i ndërtimit të urës së re të Bogovës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pasurisë	Objekt		Vlera lekë	Shënime
					Sip e shpronësuar	Çmimi lekë/m ²		
1	Iljaz	Hariz	Hysko	305/3	40	11358.5	453340	
2	Bezat	Celnik	Hoxhollari	310/8	60	11358.5	681510	
3	Renato	Skënder	Çuni	301/53	160	3400000	3400000	

4.534.850

Shpenzime procedurale të publikimit 116 700 lekësh
Vlera totale e shpronësimit 4 651 550 lekësh

VENDIM
Nr.815, datë 4.12.2003

**PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR
STUDIMIN DHE PROJEKTIMIN E URËS SË GOMSIQES NË AKSIN RRUGOR VAU I
DEJËS - KOMAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve që, për fondin prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë", me shoqërinë këshilluese "PBV Konstruksion" sh.p.k., Tiranë, për studimin dhe projektimin e urës së Gomsiqes në aksin rrugor Vau i Dejës-Koman.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Investime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Projekti të përfundojë brenda 25 ditëve nga lidhja e kontratës.

4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.34, datë 8.12.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.11.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.39 Akti që i përket:

KËRKUES:

**QENDRA PËR ZHVILLIMIN DHE DEMOKRATIZIMIN E INSTITUCIONEVE
GRUPI SHQIPTAR I TË DREJTAVE TË NJERIUT
LIDHJA E GAZETARËVE SHQIPTARË
SHOQATA E GAZETARËVE PROFESIONISTË
SINDIKATA E GAZETARËVE SHQIPTARË,** të gjithë të përfaqësuar nga Darian Pavli,

me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: ZOTI FATOS NANO, KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sokol Shazi, me autorizim.

OBJEKTI: Deklarimi si antikushtetues i urdhrin nr.226, datë 20.8.2002 të Kryeministrit “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 22, 23, 131/c e 134/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 10 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Për deklarinin si antikushtetues të urdhrin të mësipërm, kërkuesit kanë paraqitur këto shkaqe kryesore:

- Urdhri krijon një rregull të përgjithshëm sjelljeje me karakter normativ ndalues për të gjithë administratën qendrore, si dhe të gjitha organet e medias. Ai nulifikon edhe të drejtën e mediave (dhe të publikut) për të marrë informacionet që vetë nëpunësit, në mënyrë vullnetare ose në përputhje me ligjin, mund t’u komunikojnë mediave.

- Urdhri cenon para së gjithash lirinë e shprehjes së nëpunësve të lartë civilë, si dhe të drejtën themelore të gazetarëve dhe të publikut në përgjithësi për t’u informuar, në lidhje me veprimtarinë e organeve shtetërore.

- Urdhri është në thelb një akt normativ i maskuar në formën e një urdhri të brendshëm dhe prandaj, nga pikëpamja e shqyrtimit të kushtetutshmërisë, duhet trajtuar si akt me karakter normativ. Ai është produkt i abuzimit antikushtetues të kompetencës së Kryeministrit për të nxjerrë urdhra dhe si i tillë duhet të shfuqizohet. Përndryshe, do të krijohej një paradoks kushtetues, ku ekzekutivi do të mund të shmangte kontrollin kushtetues të akteve të tij normative, thjesht, duke i veshur ato me një aparençë jonormative.

- Urdhri është në kundërshtim me nenet 17, 22 e 23 të Kushtetutës, si dhe me nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, pasi përbën ndërhyrje në lirinë e shprehjes; një ndërhyrje e tillë nuk është parashikuar me ligj, ajo nuk ka qëllim legjitim dhe nuk është e nevojshme të bëhet në një shoqëri demokratike.

GJYKATA KUSHTETUESE,

që në fillim të shqyrtimit të çështjes,

V Ë R E N:

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar deklaroi se Kryeministri, me urdhrin nr.157, datë 12.11.2003, ka revokuar urdhrin nr.226, datë 20.8.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”, i cili kërkohet të deklarohet si antikushtetues nga kërkuesit. Një kopje e urdhrin revokues u administrua gjatë gjykimit.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur nuk ka më objektin e saj, sepse urdhri që kontestohet nuk ekziston, pasi ai është revokuar nga vetë organi që e ka nxjerrë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 12.12.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë